



Republika e Kosovës * Republic of Kosovo
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 28.08.2025
Nr.09/ 7097/2025

KONTRATË PËR FURNIZIM

Numri i kontratës ¹: 659-25-5613-1-2-1/C665 & KKHE-25-032-1-2-1

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

N.T.P., Bletaria Egzoni", Minatori, GJAKOVË, (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Furnizim të fermerëve me paisje për bletarë me numër identifikues: 659-25-5613-1-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Nr.	Grupi
1	Furnizim të fermerëve me paisje për bletarë

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues. Kohëzgjatja e kontratës është me afat prej katërdhjetë (40) diteve nga nënshkrimi i saj mes palëve kontraktuese

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 11,111.00 €; [Njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë] Euro. Ky projekt është në bashkfinancim me fermerë (8,888.80 Euro – Komuna H.E dhe pjesa tjetër fermeret)

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	28.08.2025
Vula:	

Për Furnizuesin N.T.P., Bletaria Egzoni"

Emri:	Egëzon Agushi
Pozita:	Drejtor ekzekutiv
Nënshkrimi:	
Data:	28.08.2025
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-25-5613-1-2-1/C665

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës në shënime kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	9.1	[Sigurimi i ekzekutimit 10% e vlerës së kontratës për 90 dite]
Sigurimi	10.1	[Specifikoni kërkesat specifike të sigurimit]
Programi i ekzekutimit	11	[Programi i ekzekutimit 40 dite nga data e hyrjes në fuqi të kontratës]
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	[Te gjitha tatimet dhe taksat bien në përgjegjësi të Kontraktuesit(OE)]
Patentat dhe licencat	13.1	[Specifikoni nëse ka ndonjë shmangie nga Neni 13 i KPK]
Cilësia e furnizimeve	18.2	[Furnizimet duhet të jenë konform specifikave të kërkuara]
Vonesat në ekzekutim	16.1	Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës
Inspektimi dhe testimi	19.2	[Mallrat duhet të pranohen sipas specifikimit]
Pagesa	20.1	[Pagesa do të bëhet brenda 30 dite pas pranimit të furnizimit]
Dorëzimi	21.3	[Specifikoni kërkesat specifike të paketimit]
Obligimet e garancionit	24.1	[Fletgarancion 12 muaj nga momenti i pranimit nga OE-kontraktuesi. Sigurimi i kualitetit 10% e vlerës së kontratës për 12 muaj]
	24.5	[Fletgarancion 12 muaj nga momenti i pranimit nga OE-kontraktuesi. Sigurimi i kualitetit 10% e vlerës së kontratës për 12 muaj]
Shërbimet pas shitjes	25.1	[Fletgarancion 12 muaj nga momenti i pranimit nga OE-kontraktuesi. Sigurimi i kualitetit 10% e vlerës së kontratës për 12 muaj]
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	[Menaxheri i kontratës - kontraktuesi – njësia kerkuese]
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Komerciale Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]